



TERMAT E REFERENCËS PËR PERSON JURIDIK TË KONTRAKTUAR

Pozicioni:	<i>Përfaqësues Ligjor/ Jurist</i>
Projekti:	<i>Zhvillimi i Qëndrueshëm i Kapaciteteve në Sektorin e Ujit në Shqipëri</i>
Niveli i angazhimit:	<i>Kontratë konsulence me kohëzgjatje të caktuar</i>
Vendndodhja:	<i>Tiranë</i>
Kohëzgjatja:	<i>Prill – Shtator 2017</i>

I. Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB)

Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri. Shoqata është e regjistruar sipas ligjit në Gjykatën e Tiranës.

II. Angazhimi i SHUKALB në Projekt

Shoqata e Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB) ka marrë një grant nga USAID për zbatimin e projektit "Zhvillimi i Qëndrueshëm i Kapaciteteve në Sektorin e Ujit në Shqipëri", më poshtë referuar si Projekti. Granti i Projektit i është dhënë SHUKALB në kuadër të Granteve që USAID akordon për Zhvillimin e Organizatave Jo-Qeveritare dhe do të zbatohet përgjatë periudhës Tetor 2014 – Shtator 2018.

Ky projekt ka si qëllim të ndihmojë në përmbushjen e Misionit të Objektivit 4 të Strategjisë së Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime (2011-2017), në veçanti Prioritetin e Veprimt 4.a: *Krijimi i një programi kombëtar trajnimi dhe certifikimi, duke synuar përmbushjen e kërkesave të gjithë shoqërive që operojnë në fushën e ujit.* Projekti do të krijojë një program të institucionalizuar trajnimi, i cili është financiarisht i vetë-qëndrueshëm dhe do të përdoret jo vetëm për certifikimin e kandidatëve bazuar në teste kualifikuese, por edhe për të mbështetur operatorët e certifikuar dhe teknikët e kualifikuar në këtë fushë, për të përmirësuar vazhdimisht aftësitë e tyre.

Projekti ka katër komponentë si më poshtë:

Komponenti I:	Kurset e trajnimit
Komponenti II:	Programi i Certifikimit Bazuar në Testim
Komponenti III:	Trajnimi në distancë
Komponenti IV:	Zhvillimi i kapaciteteve të SHUKALB

III. Përshkrimi i detyrave

Përfaqësuesi ligjor/ Juristi do të angazhohet nën Komponentin 4: *Zhvillimi i kapaciteteve të SHUKALB*, për të ofruar shërbime konsulence juridike me qëllim përmbushjen e detyrave të mëposhtme:

i. Rishikimi dhe hartimi i Statutit të ndryshuar

Përfaqësuesi ligjor/ Juristi do të angazhohet në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të mëposhtme, por pa u limituar në:

- Të njihet me Statutin aktual dhe dokumentacionin mbështetës ekzistues të SHUKALB;
- Të identifikojë nenet ekzistuese për ndryshim në bashkëpunim të ngushtë me stafin përgjegjës të SHUKALB;
- Të hartojë draftin e parë të Statutit të ndryshuar të SHUKALB në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Të bëjë prezantimin e draft Statutit të ndryshuar para Bordit Drejtues të SHUKALB;
- Të hartojë draftin final të Statutit të ndryshuar i cili të reflektojë komentet e Bordit dhe të stafit të SHUKALB;
- Të jetë i/e gatshëm për të organizuar takime periodike me përfaqësues të SHUKALB;
- Të përfaqësojë ligjërisht SHUKALB në procesin e noterizimit të dokumentacionit të nevojshëm për ndryshimin e Statutit në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë;
- Të përfaqësojë ligjërisht SHUKALB në procesin e aplikimit për ndryshim të Statutit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë;
- Të përfundojë me sukses regjistrimin e Statutit të ndryshuar të SHUKALB në Gjykatë;
- Të ndjekë hapat e nevojshme që duhen për procesin e ndryshimi të adresës së NIPT-it dhe marrjen e tij fizikisht.

ii. Licensimi i SHUKALB pranë QKL

Përfaqësuesi ligjor/ Juristi do të angazhohet në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të mëposhtme, por pa u limituar në:

- Të përgatisë të gjithë dokumentacionin për licensim të SHUKALB sipas kritereve të kërkuara nga QKL dhe Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë,

për ofrimin e programeve të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve të stafit të shoqërive ujësjellës kanalizime;

- Të përfaqësojë ligjërisht SHUKALB në procesin e licensimit pranë QKL duke përmbushur kriteret e kërkuara nga QKL dhe Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë deri në nxjerrjen e licensës.

IV. Kriteret

- Të ketë mbaruar studimet në fushën juridike;
- Të ketë njohje të plotë dhe të përditësuar të akteve ligjore në fuqi dhe ndryshimeve të tyre për funksionimin dhe organizimin e shoqatave/organizatave jofitimprurëse në Shqipëri;
- Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në ushtrimin e profesionit të juristit dhe/ ose avokatisë;
- Të ketë eksperiencë në ofrimin e shërbimeve juridike për shoqata/organizata jofitimprurëse, veçanërisht në hartimin e statuteve dhe proceset e licensimit;
- Të jetë i/e licensuar për ushtrimin e aktivitetit të avokatisë;
- Aftësi shumë të mira komunikuese.

V. Rezultatet Kyçe

1. Regjistrimi i Statutit të ndryshuar të SHUKALB pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë;
2. Nxjerrja e Licencës për SHUKALB për ofrimin e programeve të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve të stafit të shoqërive ujësjellës kanalizime.